



AKK përfundon monitorimin, raportet u përcillen kryetarëve të Komunave



Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) muajve të fundit i është nënshtruar masave të ndëmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit Covid19, mirëpo edhe me masat e vendosura AKK për asnjë moment nuk ka ndërprerë ofrimin e shërbimeve si për qytetarët po ashtu edhe për institucionet e Republikës së Kosovës. Pos ofrimit të shërbimeve, ekspertët e AKK-së kanë qenë të përfshirë edhe në aktivitete tjera kapitale si krijimi i literaturës ligjore, profesionale e teknike për çështje kadastrale, gjeodezike e pronësore si dhe në monitorimin e punëve të Zyrave Kadastrale Komunale, kompanive të licencuara gjeodete e gjeodetëve të licencuar për periudhën kohore Dhjetor 2019 - Mars 2020. Ky aktivitet i AKK bazohet në dispozitën e nenit 4, paragrafit 10 të Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër, ku thuhet që AKK është përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve kadastrale, aktivitete këto të cilat ligjërisht janë të deleguara në Zyrat Kadastrale Komunale, kompanitë gjeodete dhe gjeodetët e licencuar. Me qëllim të realizimit të kësaj përgjegjësie AKK kishte formuar grupin punues për monitorimin e punëve dhe aktiviteteve kadastrale, i cili ishte përgjegjës për realizimin e kontrollit

të lëndëve të cilat janë të regjistruara në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK). Monitorimi i parë i këtij viti është i shtati (7) me radhë dhe i njëjti është i ndarë në tri pjesë, duke përfshirë pjesën grafike, atë pronësore-juridike dhe pjesën tekstuale. Sa i përket monitorimit, raportet me të gjeturat me datë 23 korrik janë nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti, dhe të njëjtat u janë përcjellur Kryetarëve të Komunave dhe drejtorëve të Zyrave Kadastrale Komunale, me kërkesë për eliminimin e parregullsive të evidentuara. Po ashtu përmes një shkrese Kryetarët e Komunave dhe Drejtorët e Zyrave Kadastrale Komunale janë informuar se në monitorimin e radhës që do të përfshijë periudhën pas hyrjes në fuqi të Kornizës së re të Punës Nr. AKK 2020/01, do të ndërmirren edhe masa konkrete konform kornizës ligjore për të gjithë ata që nuk zhvillojnë punët dhe aktivitetet kadastrale konform standardeve kadastrale (ose legjislationit) në fuqi. Marrja e masave buron nga Paragrafi 11, i po të njëjtit nen, ku përcaktohet se: "AKK, në bazë të mbikëqyrjes mund të shpallë urdhrin për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë inspektimit, të shpallë urdhrin për ndalimin e aktiviteteve që nuk

i plotësojnë obligimet sipas këtij ligji, të anulohet licencën për një kompani gjeodete apo gjeodet të licencuar, të anulohet certifikimin për aktivitete kadastrale të ZKK-së", po ashtu me paragrafin 2, të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ MMPH – NR. 12/19, është përcaktuar se "Në rast të keqpërdorimit të qasjeve ose dëmtimit të të dhënave kadastrale, AKK merr vendim për ndërprerjen e qasjeve dhe merr masa në pajtim me legjislationin në fuqi." Raportet e monitorimit për komuna mund të gjenden në linkun në vijim:

<http://www.kca-ks.org/raports>

Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit / Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine / Ministry of Economy and Environment	
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY	
DATA/E:	20.07.2020
PËRZAT/O:	1. Ramir L. ADROVCI, Kryetar i Komunitet Gjeodez 2. Rashid L. VITRANI, Drejtor Zyre Kadastrale Komunale Glogocë
PËRMES/PREKO/THRU GJ:	Zyrtë Elëktrore
NGA/OD/FROM:	AVNI AHMETI, Drejtor Ekzekutiv Agjencia Kadastrale e Kosovës
TEMA/SUBJEKTI/SUBJECT:	Monitorimi i punëve dhe aktiviteteve të regjistruara në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë
Firmatimi z. LLADROVCI,	
Me qëllim të ngritjes së cilësido që të dhëna në kadastrë dhe me qëllim të avancimit të ofrimit të shërbimeve kadastrale në nivel vendi, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), gjatë vitit 2019 ka kryerë njëmbëdhjetë (11) udhëzime administrative, gjatë të cilave (6) prej të cilave në fuqi të kadastrës ndikim pozitiv i të cilave ka qenë i drejtpërdrejtë për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës.	
Po ashtu, AKK në fundin ka kryerë edhe disa botime me anë të të cilave janë regjistruar dhe standardizuar të gjitha të dhënat që ndodhen në fuqi të kadastrës dhe regjistrit të të dhënave pronësore, duke filluar nga kërkesa e palës deri tek Aktvendimi për regjistrim në SIKTK.	
Për informimin e palës në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj udhëzime administrative, AKK ka organizuar takim me të gjitha zyrat kadastrale komunale (ZKK) dhe me të gjitha kompanitë gjeodete dhe gjeodetët e licencuar, me qëllim të prezantimit të ndryshimeve që kanë ndodhur me hyrjen në fuqi të kësaj udhëzime administrative. Pjesë e grupave punuese në hartimin e kësaj UA ndër të tjerë kanë qenë përfaqësues edhe nga ZKK, shoqëria e gjeodetëve të Kosovës dhe gjeodetët e licencuar.	
Bazuar në dispozitën e nenit 4, paragrafit 10 të Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër, AKK është përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve kadastrale, aktivitete këto të cilat ligjërisht janë të deleguara në zyrat kadastrale komunale, kompanitë gjeodete dhe gjeodetët e licencuar.	
Faqja 1 prej 2 Adresa: Agjencia Kadastrale e Kosovës, E.D. "Arbana e Asri Duka", nr. 25, 10000 Prishtinë, Tel. + 38380 38 32 33	

Aprovohet projekti për kadastrë të patundshmërive dhe infrastrukturë gjeohapësinore



Me datë 23 korrik 2020, në kuadër të votimit të marrëveshjeve ndërkombëtare Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar huamarrjen nga Banka Botërore për projektin për kadastrë të patundshmërive dhe infrastrukturë gjeohapësinore (REGIP). Implementimi i projektit REGIP do të ndihmojë Republikën e Kosovës në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të tokës, dhe do të kontribuojë në përmirësimin e mëtutjeshëm të shërbimeve kadastrale dhe përmirësimin e legjislacionit, duke lehtësuar mbrojtjen dhe sigurinë e të drejtave pronësore dhe krijimin e një mekanizmi të lehtë, dhe të sigurt për transaksionet e pronës së paluajtshme në vend. Objektivi zhvillimor i projektit është të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe cilësisë të administrimit të tokës, të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Po ashtu REGIP do të sigurojë mbështetje ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për vazhdimin e punëve të rindërtimit të informacioneve kadastrale, për krijimin e kadastrit të përçojave, për zhvillimin e mëtutjeshëm të kadastrit të ndërtesave, për shërbimet për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë – SIKTK, dhe për renovimin e zyrave kadastrale në Komunitet e mbetura. Gjithashtu qëllimi i mëtutjeshëm i projektit është të zbatohet strategjinë për

Teknologjinë Informative të AKK-së dhe Strategjinë e Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH) në Kosovë. Ky synim do të arrihet me rritjen e kapaciteteve të AKK-së për të menaxhuar sistemet e TI-së dhe zbatimin e mëtejshëm të IKIH-së gjatë një periudhe afatgjatë dhe krijimin e një modeli të ri të qëndrueshëm të biznesit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e mëtejshme të sistemeve të TI-së.

PROJEKTI REGIP PËRBËHET PREJ KATËR KOMPONENTEVE SI VIJOJNË:

Komponenti A - Politikat, Ligjore dhe Institucionale me nënkomponentet “Zhvillimi i Strategjisë dhe Planit të Biznesit 5 vjeçar për AKK-në”, “Mbështetje për hartim të ligjeve, udhëzuesve dhe kornizave të punës për AKK”, “Analiza e ndikimit të dokumenteve kadastrale në tregun e pronave në Republikën e Kosovës”.

Komponenti B - Modernizimi i Kadastrit me nënkomponentet “Rindërtimi i kadastrit”, “Shërbimet për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë – SIKTK”, “Zhvillimi i kadastrit të përçojave dhe Zhvillimi i regjistrat të ndërtesave” dhe

“Renovimi i zyrave kadastrale në Komunitet e mbetura”.

Komponenti C - Teknologjia Informative dhe Infrastruktura Gjeohapësinore me nënkomponentet “Zhvillim i mëtejshëm i SIKTK – Arkitektura e Orientuar në Shërbime (AOSH)”, “Arkivi Digjital i AKK-së – Skanimi i dokumenteve arkivore kadastrale”, “Zhvillimi i Gjeoportalit të ri shtetëror”, “Qëndrueshmëria e sistemeve të Teknologjisë Informative të AKK”, “Prodhimi i ortofotove të reja për territorin e Republikës së Kosovës”, “Mbështetje për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH)”, “Mbështetje për rrjetin shtetëror gjeodezik të GPS – KOPOS”.

Komponenti D - Menaxhimi i Projektit me nënkomponentet “Ngritja e Kapaciteteve”, “Informimi Publik”, “Monitorimi dhe Vlerësimi i Projektit”.



Hartografia, AKK trajnon FSK-në



Si rezultat i takimit të mbajtur me datë 25.02.2020 mes Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së z. Avni Ahmeti dhe përfaqësuesve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) respektivisht Nënkolonelit Valdet Berisha, Majorit Blerim Maloku dhe Kapitenit Visar Nura, Agjencia Kadastrale e Kosovës kishte ndërmarrë një varg trajnimesh intensive disaditore për personelin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në fushën e hartografisë. Ndërsa për të prezantuar të arritura nga trajnimi, me datë 17 korrik 2020 në ambientet e Forcës së Sigurisë së Kosovës është mbajtur një takim gjithëpërfshirës

mes prijësve dhe përfaqësuesve të nivelit të lartë të institucioneve respektive. Gjatë takimit pos që u prezantuan rezultatet e trajnimit, u identifikuan edhe fushat e interesit të përbashkët ku bashkëpunimi do të intensifikohet në të ardhmen. Kryesisht tema e takimit kishte të bënte me të dhënat gjeohapësinore, aplikacionet për përpunimin e tyre, zhvillimet teknologjike në fushën e shpërndarjes së të dhënave e ngjashëm. Për të bërë më të lehtë bashkëpunimin, palët u pajtuan që i njejtë të formalizohet me nënshkrimin e një memorandumit për bashkëpunim, ku më

në detaje do të specifikoheshin aktivitetet e interesit, përgjegjësitë e institucioneve e ngjashëm. Në takimin në fjalë, delegacionit të AKK-së i priu Kryeshefi Ekzekutiv z. Avni Ahmeti i shoqëruar edhe nga drejtoresha e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit z-nja Afërdita Thaçi dhe Eksperti i GIS-it z. Avni Rrustemi, ndërsa ekipit të FSK i printe Gjeneral Brigade Jeton Dreshaj, i shoqëruar nga Kolonel Agron Bajrami, Kolonel Ejup Maqedonci, Kolonel Haki Xhemaili, Major Blerim Maloku dhe Kapiten z. Visar Nura.

Prona thëllon bashkëpunimin AKK-USAID



Me qëllim të prezantimit të aktiviteteve të ndërsjella si dhe për të identifikuar fushat e interesit të përbashkët ku bashkëpunimi do të mund të intensifikohej, me datë 9 korrik 2020 është mbajtur një takim virtual mes ekupeve gjithëpërfshirëse të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe USAID. Në fillim të takimit Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti prezantoi fushat e përgjegjësisë së AKK-së respektivisht administrimin e regjistrave pronësorë, kadastrën, gjeodezinë, hartografinë, gjeoinformacionin dhe sistemin e unifikuar të adresave si dhe prezantoi

të arriturat e AKK-së në realizim të projekteve kapitale, reformat në kadastër, dokumentet profesionale, gjithëpërfshirjen në shfrytëzim të të drejtave pronësore e ngjashëm. Një pjesë e takimit iu kushtua edhe vlerësimit të bashkëpunimit të AKK-së me projektin për të drejta pronësore të USAID i cili kishte kulmuar me përpilimin e strategjisë për të drejta pronësore, me funksionalizimin e e-Kioskave në disa komuna dhe me përfshirjen e grave në shfrytëzim të të drejtave pronësore. Për të fuqizuar se bashkëpunimi kishte qenë produktiv, z. Ahmeti potencoi se të gjeturat

nga Strategjia për të Drejta Pronësore janë përfshirë edhe në reformat ligjore të ndërmarra nga AKK, respektivisht në 11 Udhëzimet e reja administrative nga fusha e pronës e adresave. Si rezultat i tyre pastaj u arrit thjeshtimi i procedurave për regjistrim të pronës, avancimi i bazës ligjore për shpërndarjen e produkteve online, përkrahja fundamentale që AKK ia ofroi procesit të legalizimit, avancimi i të drejtave të gruas në pronë, përfshirja e pakicave etnike në shfrytëzim të të drejtave pronësore, etj. Po ashtu, edhe përfaqësuesit e USAID respektivisht z-nja Christina Davis, z-nja Perihane Ymeri-Ustaibo dhe z-nja Zana Berisha vlerësuan bashkëpunimin në të shkuarën dhe u shprehën të interesuara për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, sidomos gjatë fazave të dizajnit të projektit vijues për të drejta pronësore të USAID-it.

AVANCIMET NË SIKTK

A.3 NDËRTESTAT / ZGRADE / BUILDINGS

Numri i adresë Bregu zgarde Building Number	Lloji i adresës Vista zgarde Building Type	Shfrytëzimi aktual i adresës Trenutoe kurorjeje zgarde Building Current Use	Sipërfaqja Povirina Area (m ²)	Katet Spatet Floors	Leja e ndërimit Gradjevska drevola Building permit	Viti i ndëimit Godinje izgradnje Construction Year	Cmimi i kontraktit Ugovorena cena Contract Price	Azhuruar Azhurirano Updated
O-70101001-00056-0-7-0	Banimit Stanovjanje/Housing	Shëqep/Kupa/House	560	2				05.03.2020

A.3.3 KATET E NDËRTESËS / SPRAT ZGRADE / BUILDING FLOORS

KATĒT E NĒRĪTESĒŠ / SPRAT ZGRADE / BUILDING FLOORS	SiprfaĶa (m ²) / Površina (m ²) / Area (m ²)
Bodrum (-1) / Podrum (-1) / Basement (-1)	559
Kati 1.pārē / Prvi sprat / First floor	600

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Tit drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personat Licen brej ID. No.	Vendbanimi Pribhelistat Resident	Kodi postat Postanski kod Postal code	Hollitit e adresit Pojedinoshtat Address details	Pjesa e prons Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Aktualizuar Updated
Poseidim individual / Individualna Drazvina / single possessor			PRISHTINE - PRISHTINA / PRISHTINE - PRISHTINA / PRISHTINE - PRISHTINA /		MUSTAF KRUIJA	1/1		03.03.2020

Në fund të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020 Agjencia Kadastrale e Kosovës ka publikuar 11 Udhëzime Administrative, Kornizën e punës, Udhëzues të procedurave të regjistrimit të pronës, Doracakë të ndryshëm profesional e teknik, të gjitha këto me qëllim të thjeshtësimit dhe qartësimit të procedurave për mirëmbajtjen e të dhënave kadastrale. Kufizimet dhe ndryshimet e procedurave në rrjedhën e punës dhe aktiviteteve kadastrale kanë rezultuar edhe me nevojën e ndryshimeve në sistemet kadastrale elektronike të cilat menaxhohen nga AKK dhe shfrytëzohen nga AKK dhe ZKK-të. AKK edhe pse me staf të reduktuar dhe me kapacitete minimale gjatë kësaj periudhe të parë të vitit 2020, ka bërë analiza shtesë të sistemeve dhe janë identifikuar ndryshimet të cilat duhen realizuar në secilin nga to. Hyrja në fuqi e Udhëzimeve administrative NR. 12/19 PËR NDARJEN DHE REGJISTRIMIN E PARCELËS dhe NR. 11/19 PËR NDARJEN E NDËRTESËS DHE TË PJESËS SË NDËRTESËS ka obliguar bankat dhe të gjitha institucionet e tjera mikrofinanciare të cilat japin kredi, që regjistrimin e hipotekave ta realizojnë me automatizëm në formë digjitale duke shfrytëzuar ueb shërbimet e zhvilluara nga ana e AKK për këtë qëllim ndërsa aprovimi i tyre në SIKTK të bëhet nga ana e zyrtarëve të ZKK-ve. Gjithashtu në kuadër të procesit për avancime shtesë në regjistrimin e hipotekave është realizuar edhe gjenerimi i prioriteteve për hipotekat në mënyrë automatike si dhe janë realizuar disa ndryshime edhe në formën dhe përmbajtjen e aktvendimit për regjistrimin e tyre. Fuqizimi i këtyre udhëzimeve ka afektuar edhe formën e përmbajtjen e të

gjitha llojeve të aktvendimeve të cilat ZKK-të i marrin gjatë mirëmbajtjes së rregullt të të dhënave kadastrale. Këto aktvendime janë inkuadruar në SIKTK me po këtë qëllim që në rast të ndryshimeve në legjislacion, ndryshimet e nevojshme në përmbajtjen e tyre të realizohen në të njejtën kohë dhe në të njejtën formë për të gjitha ZKK-të e Republikës së Kosovës nga ana e AKK. Me Kornizën e re të punës janë ristandardizuar formularët për regjistrimin e Ndërtesave dhe Pjesëve të ndërtesave me të dhëna më të plota të cila do të shfrytëzohen edhe në regjistrimin e objekteve gjatë procesit të legalizimit. Standardizimi i formularëve ka mundësuar që regjistrimi i tyre në SIKTK të realizohet duke thirrur të dhënat direkt nga formulari, procedurë kjo që zyrtarëve të ZKK-ve do tu shkurtojë jashtëzakonisht shumë kohën e azhurnimit dhe do të zvogëlojë mundësinë e gabimeve në regjistrim. Ndryshime në Kornizën e punës janë bërë edhe në formatin e ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës. Numri i parcelës është larguar nga formati i regjistrimit të ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës. Kjo rrjedhimisht ka ndikuar edhe në ndryshimin e logjikës së regjistrimit të 9 llojeve të lëndëve në SIKTK, të gjitha ato lëndë që kanë të bëjnë me regjistrimin, modifikimin, ndarjen e bashkimit, e ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave. Përveç ndryshimit të formatit të pjesët e ndërtesës me largimin e numrit të parcelës është ndryshuar edhe numrimi i njësive në nivelin e përdhësës apo suteranit. Te pjesët e ndërtesës në nivelin e përdhësës apo suteranit e poshtë do të numërohen prej numrit 1 deri në n, duke i shtuar parashtresën B secilës njësi banesore që gjendet në përdhësë apo

suteren si p.sh. O-71914059155-1-Bn-0.....
O-71914059-155-1-Bn-0. Të gjitha këto
ndryshime kanë ndikuar që të bëhen
ndryshime edhe në SIKTK. Legjislacioni
i ri në fuqi obligon edhe regjistrimin e
hapësirave të përbashkëta, e kjo mundësi
për regjistrimin e tyre është realizuar
edhe në SIKTK ku numërimi i hapësirave
të përbashkëta bëhet nga niveli me i ulët
i ndërtesës (p.sh. bodrumi) deri te niveli
më i lartë duke i shtuar parashtesën HP
para numrit të njësisë, p.sh. O-71914059-
155-2-HP1-0 O-71914059-155-2-HPn-0.
Një zhvillim tjetër i nevojshëm për tu
realizuar në SIKTK si pasojë e hyrjes në fuqi
të Kornizës së punës ka qenë edhe lejimi
i bashkimit të parcelave me të drejta të
ndryshme. Gjithashtu janë realizuar edhe
ndërhyrje në hapa dhe funksionalitete të
tjera me qëllim të rritjes së performancës
së sistemit dhe shpejtitimit të procedurave
gjatë azhurnimit.

Informata mbi AKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës (në vijim të tekstit AKK) është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore (në vijim të tekstit, IKIH) dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.

KRYESHEFI EKZEKUTIV
Avni Ahmeti
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORATI LIGJOR
Bashkim Shaqiri
bashkim.shaqiri@rks-gov.net

DREJTORATI I FINANCIVE
DHE ADMINISTRATËS
Fazile Hamiti
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORATI I TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT
Afërdita Thaçi
Afërdita.Thaci@rks-gov.net

DREJTORATI I KADASTRËS
Korab Ahmetaj
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË
Ibadete Rexhepi
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE
INFORMATA TË PËRGJITHSHME
akk@rks-gov.net